

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Digjitalizim i arkivit historik” për Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (FPP):

Shërbim skanimi – 79999100-4

VLERA E FONDIT LIMIT: 8,666,662 (tetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) **Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP i ndryshuar, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriterë duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke vlerësuar që plotësimi i kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të vendosura në pikën 1 të shtojcës 9 të DST provon mjaftueshëm përshtatshmërinë profesionale të ofertuesve.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të kontratës. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr. 7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, është vendosur me qëllim sigurimin e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi, si dhe AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OE ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, 55 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në dispozitat e sipërcituara.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është përcaktuar bazuar në legjislacionin e fushës, konkretisht, nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar kontratën, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të ketë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi, në përbërje të cilit të ketë të paktën 2 (dy) punonjës sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) Inxhinier i diplomuar në Informatik / Teknologji Informacioni / Elektronik ose çdo arsim tjetër i ngjashëm, i cili të sigurojë instalimin, mirëmbajtjen e pajisjeve gjatë zbatimit të kontratës sipas specifikimeve teknike.
- 1 (një) specialist informatike ose teknologji informacioni.

Në lidhje me stafin teknik të paraqitet :

- Diplomë Universitare;
- Kontratë pune (e vlefshme);
- CV personale për secilin punonjës;
- Listëpagesat e punonjësve për muajin e fundit, të deklaruar në organet tatimore nga data e hapjes së ofertave, sipas formës së parashikuara nga legjislacioni tatimor në fuqi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT.

Dokumentet provuese të kërkuar më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, dhe pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit kërkesat për kualifikim mund të bazohen në aftësinë teknike dhe profesionale dhe autoriteti/enti kontraktor mund të vendosë kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike dhe përvojën e nevojshme për zbatimin e kontratës sipas një standardi të përshtatshëm cilësie, si dhe në mbështetje të nenit 41, pika 2 dhe pika 4, shkronjat “b” dhe “c”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, lidhur me personelin kryesor të nevojshëm për zbatimin e objektit të prokurimit dhe fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e tij, kërkesa për disponimin e të paktën 2 (dy) punonjësve sipas profileve të

përcaktuara është vendosur në funksion të garantimit të kapacitetit teknik dhe profesional të operatorit ekonomik për realizimin me sukses të shërbimit objekt prokurimi.

Duke qenë se realizimi i kontratës përfshin instalimin, konfigurimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit, si dhe realizimin e proceseve teknike të lidhura me shërbimin e skanimit, disponimi i një inxhinieri të diplomuar në Informatikë/Teknologji Informacioni/Elektronikë ose arsim tjetër të ngjashëm dhe i një specialisti në Informatikë ose Teknologji Informacioni vlerësohet i nevojshëm për të garantuar instalimin dhe konfigurimin korrekt të pajisjeve, ndërhyrjen teknike gjatë zbatimit të kontratës dhe vijueshmërinë e funksionimit të tyre.

Kërkesa për paraqitjen e diplomës universitare synon të provojë formimin profesional të personelit të angazhuar, CV-ja shërben për evidentimin e profilit dhe kualifikimit profesional të tij, ndërsa kontrata e vlefshme e punës shërben për të provuar marrëdhënien e punës dhe disponueshmërinë e personelit për realizimin e kontratës. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e shërbimit dhe është përcaktuar në funksion të garantimit të realizimit të tij me cilësi dhe brenda afateve të kërkuara. Listëpagesat dhe dokumentacioni shoqërues shërbejnë si dokumente provuese për plotësimin e këtij kriteri, duke vërtetuar se operatori ekonomik disponon personel aktiv dhe kapacitete reale për kryerjen e shërbimit. Punësimi i tyre të paktën gjatë muajit të fundit të deklaruar garanton gjithashtu se personeli është i integruar në strukturën e operatorit dhe i njohur me standardet dhe procedurat e punës së tij.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë pajisjet e nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

Nr.	Emërtimi	Njësi	Sasi
1.	Skaner Rotativ Profesional	copë	1
2.	Skaner Profesional i Mesëm	copë	1
3.	Skaner Planar A3 Tip Libri (Bookscan)	copë	1

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, duhet të paraqitet:

- Dokumentacion për pajisjet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë). Dokumentacioni i paraqitur duhet të përmbajë të dhëna të mjaftueshme për identifikimin e qartë të makinerive pajisjeve të kërkuara.
- katalog/skedë teknike të prodhuesit, ku të tregohen qartë karakteristikat e pajisjeve, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara.

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, dhe pika 4, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale dhe burimet teknike të nevojshme për zbatimin e kontratës, si dhe të nenit 41, pika 2 dhe pika 4, shkronja “ç”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, i cili parashikon, ndër elementet për provimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale, “mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”, kërkesa për disponimin e pajisjeve të përcaktuara në pikën 2.3.3 është vendosur në funksion të garantimit të kapacitetit teknik të nevojshëm për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin realizimin e një shërbimi profesional skanimit, disponimi i një Skaneri Rotativ Profesional, një Skaneri Profesional të Mesëm dhe një Skaneri Planar A3 Tip Libri (Bookscan) është i nevojshëm për realizimin e proceseve të skanimit për kategoritë dhe formatet e ndryshme të dokumentacionit, në përputhje me kërkesat dhe specifikimet teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Parashikimi që pajisjet mund të disponohen në pronësi, me qira, me huapërdorje apo nëpërmjet çdo forme tjetër të ligjshme që garanton të drejtën e përdorimit synon të provojë disponueshmërinë efektive të tyre për ekzekutimin e kontratës, pa e kufizuar operatorin ekonomik vetëm në pajisje në pronësi. Dokumentacioni që provon pronësinë ose të drejtën e përdorimit kërkohet për të mundësuar verifikimin e disponueshmërisë së pajisjeve, ndërsa kërkesa që dokumentacioni të përmbajë të dhëna të mjaftueshme identifikuese synon identifikimin e qartë të pajisjeve të deklaruara. Kërkesa për katalogun/skedën teknike të prodhuesit është përcaktuar me qëllim verifikimin e karakteristikave teknike të pajisjeve dhe krahasimin e tyre me kërkesat e parashikuara në specifikimet teknike.

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë certifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

- S SH EN ISO 9001 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente;

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Në mbështetje të nenit 79 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me standardet e sigurimit të cilësisë, si dhe të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilit certifikatat e cilësisë duhet të jenë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht e drejtpërdrejt me objektin e prokurimit, të jenë proporcionale dhe të respektojnë parimin e mosdiskriminimit, duke

u pranuar edhe certifikatat apo dokumentet ekuivalente/barasvlershme, kërkesa që operatori ekonomik të disponojë certifikatë të vlefshme SSH EN ISO 9001 “Sistemet e menaxhimit të cilësisë”, ose ekuivalente, është vendosur me qëllim garantimin e realizimit të shërbimit nëpërmjet proceseve të organizuara dhe të kontrolluara të menaxhimit të cilësisë.

Duke qenë se objekti i kontratës përfshin procese të ndërlidhura që lidhen me instalimin dhe konfigurimin e pajisjeve dhe sistemit, realizimin e shërbimit të skanimit, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit, si dhe trajnimin e stafit, zbatimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë lidhet drejtpërdrejt me organizimin, kontrollin dhe monitorimin e proceseve të punës, përcaktimin e përgjegjësiave dhe trajtimin e mospërputhjeve që mund të evidentohen gjatë realizimit të kontratës.

Kriteri është i lidhur me natyrën dhe cilësinë e shërbimit që do të ofrohet dhe është përcaktuar në mënyrë proporcionale me objektin e kontratës, ndërsa parashikimi “ose ekuivalente” garanton pranimin e standardeve të barasvlershme dhe respektimin e parimit të mosdiskriminimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se merr persipër instalimin, montimin, shërbimin e skanimit, konfigurimin, mirembajtjen e pajisjeve dhe sistemit si dhe trajnimin e stafit.

Argumentimi: *Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomikë, si dhe të nenit 41, pikat 2 dhe 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilit Autoriteti/Enti Kontraktor mund të përcaktojë, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, kritere të tjera të veçanta në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, është përcaktuar kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër instalimin, montimin, shërbimin e skanimit, konfigurimin, mirëmbajtjen e pajisjeve dhe sistemit, si dhe trajnimin e stafit.*

Këto veprimtari përbëjnë komponentë të drejtpërdrejtë të realizimit të objektit të prokurimit dhe janë të nevojshme për instalimin, vënien në funksion dhe përdorimin e plotë të pajisjeve dhe sistemit, si dhe për vijueshmërinë e funksionimit të tyre gjatë zbatimit të kontratës.

Nëpërmjet kësaj deklarate synohet të sigurohet angazhimi i operatorit ekonomik për realizimin e të gjithë komponentëve të shërbimit të kërkuar, duke garantuar ekzekutimin e plotë të objektit të kontratës dhe duke shmangur krijimin e nevojave apo kostove shtesë për Autoritetin Kontraktor.

2.3.6 Operatoret ekonomike duhet të paraqesin një deklaratë me anë të së cilës të deklarojnë se marrin përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.3 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: *Në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, si dhe të nenit 41, pikat 2 dhe 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, sipas të cilit Autoriteti/Enti Kontraktor mund të*

përcaktojnë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, është përcaktuar kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë deklaratë me anë të së cilës merr përsipër transportin e pajisjeve të kërkuara në pikën 2.3.3 në adresën e Autoritetit Kontraktor.

Duke qenë se pajisjet e kërkuara përbëjnë mjete teknike të nevojshme për realizimin e shërbimit dhe duhet të jenë fizikisht të disponueshme në vendin ku do të ekzekutohet kontrata, transporti i tyre në adresën e Autoritetit Kontraktor përbën një element të nevojshëm për realizimin e plotë të objektit të prokurimit.

Kërkesa nuk kushtëzon mënyrën se si operatori ekonomik duhet të realizojë transportin dhe nuk kërkon disponimin në pronësi të një mjeti të caktuar transporti, por vetëm marrjen përsipër të realizimit të këtij detyrimi. Për rrjedhojë, kërkesa lidhet drejtpërdrejt me ekzekutimin e kontratës dhe nuk krijon kufizim të panevojshëm për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike për procedurën e prokurimit me objekt **“Digjitalizimi i arkivit historik”** janë hartuar dhe përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, në funksion të nevojave konkrete të institucionit dhe të kërkesave që lidhen me realizimin e objektit të prokurimit. Dokumentacioni përkatës është përcjellë pranë Operatorit të Blerjeve të Përqendruara me shkresën nr. 6576/7 prot., datë 11.06.2026, si dhe me shkresën nr. 6576/10 prot., datë 07.07.2026.

Për rrjedhojë, specifikimet teknike që do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e procedurës janë ato të përcaktuara dhe të përcjella nga Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shkresave të sipërcituara, duke reflektuar kërkesat teknike dhe funksionale të nevojshme për realizimin e shërbimit objekt prokurimi.